

armatosur. Rrugën e kthimit për në Kosovë e ka marr më **18.07.1998**, së bashku me nëntë burra nga fshati i tij. Në bjeshkën **Gjeravica/Đeravica**, ai dhe shokët kanë rënë në pusi të forcave serbe. Duke ikur nga të shtënat, anëtarët e grupit janë shpërndarë në të gjitha anët. Ramadanin nga ajo ditë askush nuk e ka parë të gjallë kurrë më. Në regjistrin e të zhdukurve të KNKK-së, rasti i tij është evidentuar me numrin rendor BLG-802603-01.

Burimet: deklarata S.F, FDH-29922; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

Hajdar (Rrustë) Gjocaj

(1928, shqiptar nga Baballoqi/Babaloc, komuna e Deçanit/Deçani, një fëmijë, bujk)

Hajdari i moshëthyer jetonte me familjen e vet në fshatin **Baballoq/Babaloc**. Në datën **20.07.1998**, forcat serbe filluan bombardimin e fshatit me predha minahedhëse. Njëra prej tyre e qëlloi Hajdarin. Kushëriri Milaimi e kishte gjetur atë pa shpirt afro 200 metra larg shtëpisë familjare. Me ndihmën e disa pjesëtarëve të UÇK-së, ai e kishte bartur trupin e pajetë të Hajdarit në brendi të shtëpisë. Në mbrëmje, Hajdari u varros në afërsi të xhamisë së fshatit, ku prehet edhe sot.

Burimi: deklarata S.G, FDH-19221.

Mladen (Arsen) Batančev

(27.10.1965, serb nga Knezhevci i Ri, komuna e Kikindës, dy fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Zoltan (Francika) Bicok

(22.10.1964, hungarez nga Horgoshi, komuna e Kanjzhës, dy fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Mladeni dhe Zoltani punonin në stacionin policor të Knezhevcit të Ri. Në muajin qershor të vitit 1998, u dërguan në Kosovë, në komunën e Deçanit/Deçani. Në natën mes datave **22** dhe **23.07.1998**, në fshatin **Rastavicë/Rastavica**, njësi i tyre u ndesh më pjesëtarët e UÇK-së. Zoltani e ka humbur jetën nga bomba, të cilën ai vet e kishte aktivizuar aksidentalisht. Mlladeni

vetëm u plagos me këtë rast. Atë e çuan menjëherë në AMU në Beograd. Ndërroi jetë nga plagët e rënda më **29.07.1998**. Zoltani u varros më 24.07.1998, në varrezat e qytetit Crvenkë.

Burimet: deklarata M.B, FDH-25387; KKKMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; Z. Stijović, *Kosmet...*, 109; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 13, 14; SMIP, *Teroristički...*, III, 935, 936.

Hisen (Malë) Arifi

(29.11.1964, shqiptar nga fshati Pacaj, komuna e Gjakovës/Đakovica, mësues, katër fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Hiseni e vijonte Shkollën e Mesme Policore në Vushtrri/Vučitrn, ndërsa diplomoi në Fakultetin Pedagogjik në Prishtinë/Priştina. Punonte si mësues në fshatin Sheremet/Šeremet. Në vitin 1993, e arrestuan për shkak të posedimit ilegal të armëve. U dënua me 6 muaj burgim. Sërish e arrestuan në vitin 1994, për shkak të angazhimit në sindikatën e policëve shqiptarë, të cilët e braktisën MPB-në e Serbisë. Pas arrestimit të fundit, Hiseni e braktisi vendin dhe shkoi në Austri. Qëndroi atje për një kohë të shkurtër dhe, më pas, sërish u kthye në Kosovë. Mori pjesë në demonstratat kundër regjimit serb. Në muajin prill të vitit 1998, iu bashkëngjit UÇK-së që shtabin lokal e kishte në fshatin Smolicë/Smonica. Ka shkuar disa herë në Shqipëri për të siguruar armatime për bashkëluftëtarët në Kosovë. U plagos në konfliktin me forcat serbe që u zhvillua në mëhallën **Klavaj** të **Junikut/Junik**, më **25.07.1998**. Bashkëluftëtarët e çuan në spitalin e UÇK-së në Irzniq/Rznić, ku më 9.08.1998 dha shpirt nga plagët e rënda. Së pari e varrosën në Ratish/Ratiš. Mbetjet e tij mortore u rivarrosën më 27.07.1999, në varrezat e fshatit Sheremet/Šeremet.

Burimet: J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596.

Velibor (Miroslav) Stojanović

(14.12.1974, serb nga Vranja, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Që nga viti 1996, Velibori punonte në njësitin për intervenime të shpejta të SPB-